



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -023

PËR MBROJTJEN E TË USHQYERIT ME QUMËSHT GJIRI

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR MBROJTJEN E TË USHQYERIT ME QUMËSHT GJIRI

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj mbron të ushqyerit me qumësht gjiri përmes inkurajimit dhe promovimit të tij dhe kufizimeve në marketingun e produkteve të caktuara, të definuara sipas këtij ligji, për ushqim të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël.
2. Ky ligj është përafuar me Direktivën e Komisionit 2006/141 të datës. 22 dhjetor 2006 mbi formulën qumështore dhe formulën pasuese që amendamenton Direktivën 1999/21/EC si dhe me Rregulloren (EU) Nr. 609/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 12 qershor 2013 mbi ushqimin e destinuar për foshnjat dhe fëmijët e rinj, ushqimin për përdorime të veçanta mjekësore dhe zëvendësimin e plotë dietal për kontrollin e peshës.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij ligji zbatohen nga punëtorët shëndetësor, institucionet shëndetësore, shoqatat profesionale mjekësore, institucionet për përkujdesin e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël, prodhuesit, distributorët, personeli i marketingut të produkteve të caktuara për foshnje dhe fëmijë të vegjël dhe subjektet tjera të ligjit të definuara me këtë ligj.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimet si vijon:

1.1. **Biberon:** Shishe me cucëll thithëse artificiale e cila përdoret për ta ushqyer foshnjën apo fëmijën e vogël.

1.2. **Codex Alimentarius:** Grumbull i standardeve, praktikave, udhërrëfyeseve ose rekomandimeve tjera të pranuar ndërkombëtarisht në lidhje me ushqimin, prodhimin e ushqimit dhe sigurinë e tij.

1.3. **Codex Alimentarius Komision:** Trup i Kombeve të Bashkuara, i cili ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit dhe praktikave të drejta duke respektuar tregtimin ndërkombëtar të ushqimit.

1.4. **Cucëll mashtruese:** cucëll artificiale për tu thithur nga foshnjat.

1.5. **Distributor:** person fizik apo juridik në sektorin publik ose privat i cili, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, merret me shpërndarje dhe shitje me shumicë apo pakicë të produkteve të caktuara.

1.6. **Etiketë:** fletë, shenjë, shënim, vizatim, figurë apo çfarëdo paraqitje vizuale, e shkruar, e shtypur, e gravuar, e shënjuar, e vulosur, e ngjitur apo në ndonjë mënyrë e paraqitur në produkt të caktuar.

1.7. **Fëmijë i vogël:** fëmija me moshë nga një (1) deri në tri (3) vjeç.

1.8. **Formulë pasuese:** qumësht ose produkt i ngjashëm me qumështin, me origjinë shtazore ose bimore, i përgatitur industrialisht, në pajtueshmëri me rekomandimet relevante të standardeve të Codex Alimentarius dhe i tregtuar apo i prezantuar si i përshtatshëm për ta ushqyer foshnjën mbi moshën gjashtë (6) muajsh.

1.9. **Formulë qumështore:** produkt ushqimor i dedikuar për ushqyerje të veçantë të foshnjave në muajt e parë të jetës, i cili i plotëson nevojat e tyre ushqyese, deri sa të fillohet me ushqimin plotësues të përshtatshëm.

1.10. **Foshnjë:** fëmijë nga lindja deri në moshën dymbëdhjetë (12) muaj.

1.11. **Marketing:** promovim, shpërndarje, tregtim, reklamim, paraqitje publike e produktit, drejtpërsëdrejti apo përmes shërbimeve të informimit të gjerë.

1.12. **Mostër:** sasi e vogël e përzgjedhur e produktit që jepet falas.

1.13. **Paketim:** çfarëdo forme e ambalazhimit të produktit, si njësi e dedikuar për shitje, duke përfshirë edhe cilindo material që përdoret për mbështjellje të ambalazhit.

1.14. **Personel i marketingut:** person fizik apo juridik, funksioni i të cilit përfshin marketingun e produkteve të caktuara nga fushëveprimi i këtij ligji.

1.15. Produkt i caktuar:

1.15.1. Formula qumështore;

1.15.2. Cilido produkt tjetër të cilit i bëhet marketingu, apo në cilëndo formë tjetër paraqitet si i përshtatshëm për të ushqyer foshnjat në moshë deri në gjashtë (6) muaj;

1.15.3. Formula pasuese;

1.15.4. Cilido lloj tjetër i qumështit ose i produktit të ngjashëm me qumështin të cilit i bëhet marketingu apo në cilëndo formë tjetër paraqitet si i përshtatshëm për të ushqyer foshnjat dhe fëmijët e vegjël;

1.15.5. Ushqimi plotësues;

1.15.6. Biberoni dhe cuclat mashtruese;

1.15.7. Cilido produkt tjetër të cilin Ministria e Shëndetësisë e shpallë si “produkt të caktuar” me njoftim në Gazetën Zyrtare, për qëllime të këtij ligji.

1.16. **Promovim:** çdo mjet dhe mënyrë që përdoret për të nxitur shitjen ose blerjen e ndonjë produkti; për të paraqitur ndonjë ide apo çështje; apo për të shkaktuar efekte të dëshiruara.

1.17. **Punëtor shëndetësor:** të gjithë profesionistët shëndetësor, bashkëpunëtorët shëndetësor dhe të tjerët që punojnë në institucionet shëndetësore, përfshirë edhe vullnetarët.

1.18. **Qumësht i gjirit:** qumështi i prodhuar nga gjëndra qumështore e femrës.

1.19. **Subjekt i ligjit:** përfshin çdo person fizik dhe juridik në kuadër të fushëveprimit të këtij ligji.

1.20. **Ushqim plotësues:** ushqim i përgatitur në mënyrë industriale ose në kushte shtëpiake, si plotësim i të ushqyerit me qumësht të gjirit ose formulës pasuese, kur pas muajit të gjashtë (6) të jetës, nevojat ushqyese të foshnjës nuk plotësohen vetëm me qumësht.

1.21. **Gruaja e punësuar që ka lindur** - e punësuar e cila sapo ka lindur foshnjën, brenda kuptimit të këtij ligji, dhe e cila e ka informuar punëdhënësin për gjendjen e saj, në përputhje me këtë ligj.

1.22. **Gruaja e punësuar e cila ushqen foshnjën me qumësht gjiri-** e punësuar e cila e ushqen foshnjën me qumësht gjiri brenda kuptimit të këtij ligji dhe e cila e ka informuar punëdhënësin për gjendjen e saj, në përputhje me këtë ligj.

Neni 4

Mbrojtja e të ushqyerit me qumësht gjiri

1. Ministria e Shëndetësisë harton politika shëndetësore dhe koordinon aktivitetet për të mbrojtur të ushqyerit ekskluziv me qumësht gjiri për gjashtë (6) muajt e parë të jetës si dhe vazhdimin e të ushqyerit me të deri në moshën dy (2) vjeç e më tepër, përmes promovimit të përparësive të tij, inkurajimit dhe përkrahjes së nënave për të ushqyer foshnjat e tyre me qumësht gjiri.
2. Mbrojtja e të ushqyerit me qumësht gjiri në institucionet shëndetësore rregullohet me akt nënligjor, në pajtueshmëri me “Deklaratën Inoçenti” të viteve 1990 dhe 2005, “Dhjetë hapa drejtë ushqyerit të suksesshëm me qumësht gjiri”, “Kodin Ndërkombëtar të Marketingut të Zëvendësuesve të Qumështit të Gjirit” dhe Rezolutave pasuese relevante të Asamblesë së Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe “Strategjinë Globale për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël”.
3. Punëtorët shëndetësor duhet të mbrojnë të ushqyerit me qumësht të gjirit përmes promovimit dhe inkurajimit të tij në bazë të procedurave të përcaktuara me aktin nënligjor në pajtueshmëri me paragrafin 2 të këtij neni.
4. Të gjitha format e promovimit dhe inkurajimit të të ushqyerit me qumësht të gjirit duhet të ofrojnë informacione të sakta dhe të bazuara në fakte për: përparësitë e të ushqyerit me qumësht gjiri, ushqimin e drejtë për nënat, përgatitjen e nënës dhe foshnjës për gjidhënie si dhe mangësitë e zëvendësimit të qumështit të gjirit.
5. Shtatzëna, prindi, kujdestari dhe familjarët e ngushtë të foshnjës në institucion shëndetësor, duhet të kenë qasje të garantuar në informata dhe materiale që inkurajojnë dhe promovojnë të ushqyerit me qumësht gjiri, të cilat janë të bazuara në fakte shkencore dhe janë të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë apo subjektet e autorizuara prej saj, siç është përcaktuar me aktin nënligjor bazuar në paragrafin 2 të këtij neni.
6. Profesionistët shëndetësor obligohen të bëjnë edukim shëndetësor në lidhje me të ushqyerit me qumësht gjiri përmes komunikimit të informatave dhe ofrimit të materialeve nga paragrafi 5 i këtij neni.
7. Ministria e Shëndetësisë mban të drejtën që të nxjerrë akte nënligjore në fushën e ushqimit të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël, për të siguruar zbatimin e udhëzimeve dhe kodeve të praktikës së standardeve ndërkombëtare të ushqimit të njohura si Codex Alimentarius.

Neni 5

Të drejtat e femrës së punësuar për gjidhënie

1. Secilës grua të punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri i takojnë të gjitha të drejtat e garantuara me legjislacionin përkatës në fuqi në Kosovë.
2. Çdo e punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri, nëse nuk e shfrytëzon pushimin e lehonisë pas muajit të gjashtë të tij dhe sipas dispozitave përkatëse ligjore në fuqi, prej muajit të gjashtë (6) deri në një (1) vit ka të drejtën e pushimit me pagesë në kohëzgjatje prej dy (2) orë në ditë brenda orarit të punës, duke mos përfshirë pushimin e rregullt gjatë orarit të punës, për ta ushqyer foshnjën me qumësht gjiri, siç është përcaktuar me këtë ligj.

3. Çdo e punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri pas vitit të parë deri në dy (2) vjet ka të drejtën e një (1) orë në ditë pushim me pagesë brenda orarit të punës, për ta ushqyer foshnjën me qumësht gjiri, duke mos përfshirë pushimin e rregullt gjatë orarit të punës.

4. Çdo e punësuar që ushqen foshnjën me qumësht gjiri, pushimin me pagesë në kohëzgjatje prej (1) një apo dy (2) orë në ditë brenda orarit të punës, e shfrytëzon në fillim, në mes, apo përfundim të orarit të punës, në marrëveshje me punëdhënësin dhe për këtë e njofton me shkrim punëdhënësin bashkë me vërtetimin e mjekut se e punësuarja është në gjidhënje.

Neni 6 **Ndalesa absolute e ekspozimit**

E punësuarja që ushqen foshnjën me qumësht gjiri nuk duhet, në asnjë rrethanë, të detyrohet të punojë në vende pune në të cilat i ekspozohet rrezikut për sigurinë ose shëndetin e saj dhe foshnjës së saj, të përcaktuara sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 7 **Paketimi dhe Etiketa e produkteve të caktuara**

1. Produktet e caktuara që importohen, prodhohen, tregtohen dhe qarkullojnë në tregun e Kosovës duhet të jenë në pajtueshmëri me dispozitat e parapara me këtë ligj.

2. Ndalohet importi, prodhimi, ofrimi, shitja dhe qarkullimi në treg i produkteve të caktuara, paketimi dhe etiketa e të cilave janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

3. Etiketimi i formulës qumështore dhe formulës pasuese duhet të dizajnohet ashtu që të bëjë dallim të qartë në mes produkteve të tilla dhe të sigurojë informata të domosdoshme për përdorim adekuat të produkteve e që të mos dekurajojë të ushqyerit me qumësht gjiri. Kërkesat, kufizimet dhe ndalesat të përcaktuara me këtë paragraf, paragrafin 5 dhe paragrafin 7 të këtij neni duhen të zbatohen edhe lidhur me prezantimin e produkteve në veqanti për formën dukjen ose paketimin, materialin e paketimit që përdoret në mënyrën si janë aranzhuara, vendosura dhe reklamimin.

4. Paketimi apo etiketa e produkteve të caktuara, përpos biberonit dhe cuclës mashtruese, që importohet, prodhohet, tregtohet, ofrohet, apo në ndonjë formë tjetër qarkullon në treg duhet të përmbajë në vend të dukshëm, në mënyrë të qartë, të kuptueshme, lehtë të lexueshme, në gjuhët zyrtare, këto të dhëna:

4.1. udhëzimet e plota dhe të qarta rreth mënyrës së përgatitjes dhe përdorimit të produktit të caktuar, me fjalë dhe me vizatime të lehta për tu kuptuar;

4.2. moshën pas së cilës rekomandohet përdorimi i produktit të caktuar, në fjalë dhe numra, që në rast të ushqimit plotësues nuk mund të jetë më pak se gjashtë (6) muaj;

4.3. vërejtjen për rreziqet shëndetësore në rast të përgatitjes jo të drejtë të produktit dhe në rast të përdorimit të tij para moshës së rekomanduar;

4.4. të dhënat e plota mbi përmbajtjen, përbërësit dhe analizat ushqimore të produktit të caktuar;

4.5. kushtet e transportit dhe ruajtjes, para dhe pas hapjes së paketimit të produktit të caktuar, duke marrë parasysh kushtet klimatike;

4.6. numrin serik të prodhimit, datën e prodhimit, afatin e përdorimit ose/dhe datën e skadimit;

4.7. emrin dhe adresën vendore të prodhuesit apo distributorit;

5. Në paketim dhe etiketë të produkteve të caktuara, përveç të ushqimit plotësues, ndalohet përmbajtja e çfarëdo fotografie, vizatimi apo paraqitje grafike, përveç për të ilustruar mënyrën e përdorimit të produktit.

6. Në paketim dhe etiketë të produkteve të caktuara, me përjashtim të ushqimit plotësues, ndalohet çfarëdo lloj përmbajtje e cila deklaron apo sugjeron se ekziston marrëdhënia midis produktit të caktuar apo përbërësit të tij dhe shëndetit, duke përfshirë edhe rolin fiziologjik të lëndëve ushqyese në rritje, zhvillim dhe funksionim normal të organizmit të njeriut.

7. Përveç kërkesave nga paragrafi 4 i këtij neni, paketimi apo etiketa e produkteve të caktuara duhet të përmbajë:

7.1. Për formulat qumështore dhe formulat përcjellëse:

7.1.1. Fjalët “VINI RE” me shkronja të mëdha të shtypit, nën të cilat shkruan “Të ushqyerit me qumësht gjiri është më i miri. Qumështi i gjirit është ushqim ideal për rritje dhe zhvillim të shëndoshë të foshnjeve dhe fëmijëve të vegjël; mbron nga barkqitja dhe sëmundjet tjera” të shënuara me shkronja të madhësisë jo më pak se një e treta e madhësisë së shkronjave në emrin e produktit, dhe në asnjë rast më të vogla se dy milimetra (2 mm) në lartësi.

7.1.2. Fjalën “Kujdes” nën të cilën shkruan “Para se të vendosni të plotësoni apo zëvendësoni të ushqyerit me qumësht gjiri me këtë produkt, kërkoni këshillë nga profesionisti shëndetësor. Është me rëndësi për shëndetin e foshnjës suaj që ti përmbaheni me kujdes të gjitha udhëzimeve të përgatitjes. Nëse e përdorni biberonin, foshnja juaj mund të refuzojë të marrë gjirin. Është më higjienike ta ushqeni foshnjën nga gota” me shkronja të madhësisë jo më pak se një e treta e madhësisë së shkronjave në emrin e produktit, dhe në asnjë rast më të vogla se një milimetër e gjysmë (1.5 mm) në lartësi.

7.2. Në udhëzimet për përgatitje të formulës qumështore dhe formulës përcjellëse në formë të pluhurit duhet të jetë e shënuar:

7.2.1. formula në formë të pluhurit mund të kontaminohet me mikroorganizma gjatë përgatitjes;

7.2.2. është e domosdoshme që formula të përgatitet për një racion të vetëm dhe atë me ujë që ka temperaturë shtatëdhjetë gradë Celsius (70°C) e më shumë;

7.2.3. pas përfundimit të të ushqyerit, qumështi i përgatitur i mbetur duhet të hidhet menjëherë;

7.2.4. grafikoni ushqyes në udhëzimet për përgatitje;

7.2.5. specifikimin e burimit të proteinës;

7.2.6. ndalohen mbishkrimet “i humanizuar”, “i maternalizuar” dhe tjera me kuptim të ngjashëm; si dhe çfarëdo krahasimi me qumështin e gjirit;

7.2.7. ndalohet çfarëdo teksti i cili dekurajon të ushqyerit me qumësht gjiri; dhe

7.2.8. në rastin e formulës përcjellëse, deklaratën se ky produkt nuk duhet përdorur tek foshnjat më të vogla se gjashtë (6) muaj.

8. Paketimi apo etiketa e qumështit të kondensuar ose skremuar, në formë të lëngët ose të pluhurit, i tregtuar ose në cilëndo formë tjetër paraqitet të jetë i përshtatshëm për foshnje duhet të përmbajë fjalët: “Ky produkt nuk duhet përdorur për ushqim të foshnjave” me shkronja të madhësisë jo më pak se një e treta e madhësisë së shkronjave në emrin e produktit, dhe në asnjë mënyrë më të vogla se dy milimetra (2mm) në lartësi.

9. Paketimi apo etiketa e qumështit të zakonshëm ose atij me pak yndyrë, në formë të lëngët ose të pluhurit, i cili tregtohet ose në cilëndo formë tjetër paraqitet të jetë i përshtatshëm për foshnje duhet të përmbajë fjalët “Ky produkt nuk duhet të përdoret si burim i vetëm i ushqimit për foshnje” me shkronja të madhësisë jo më pak se një e treta e madhësisë së shkronjave në emrin e produktit, dhe në asnjë mënyrë më të vogla se dy milimetra (2mm) në lartësi.

10. Paketimi apo etiketa e biberonit apo cucllës, përveç që duhet ti përmbahet kërkesave të paragrafit 4.6 dhe 4.7 të këtij neni, duhet të përmbajë në vend të dukshëm, me porosi të qartë dhe të kuptueshme, në gjuhët zyrtare, lehtë të lexueshme, këto të dhëna:

10.1. fjalët “VINI RE” me shkronja të mëdha të shtypit, nëntë cilat shkruan: “të ushqyerit me qumësht gjiri është më i miri. Qumështi i gjirit është ushqim ideal për rritje dhe zhvillim të shëndoshë të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël; mbron nga barkqitja dhe sëmundjet tjera” e shënuar me shkronja të madhësisë jo më pak se një e treta e madhësisë së shkronjave në emrin e produktit, dhe në asnjë rast më të vogla se dy milimetra (2mm) në lartësi;

10.2. përmban tekstin: “KUJDES: Është me rëndësi për shëndetin e foshnjës suaj që ti përmbaheni me shumë kujdes udhëzimeve për pastrim dhe sterilizim. Nëse e përdorni biberonin, foshnja juaj mund të refuzojë të marrë gjirin. Të ushqyerit e foshnjës me gotë është më higjienike se të ushqyerit me biberon”, me shkronja të madhësisë jo më pak se një e treta e madhësisë së shkronjave në emrin e produktit, dhe në asnjë rast më të vogla se dy milimetra (2 mm) në lartësi;

10.3. udhëzimet për pastrim dhe sterilizim, me fjalë dhe pamje grafike;

10.4. emrin dhe adresën vendore të prodhuesit ose distributorit.

11. Paketimi apo etiketa e cuclës mashtruese, duhet të përmbajë fjalët: “KUJDES: Përdorimi i cuclës mashtruese mund të ndikojë negativisht në marrje të gjirit” me shkronja jo më të vogla se një e treta e madhësisë së shkronjave të emrit të produktit dhe në asnjë rast më të vogla se dy milimetra (2mm) në lartësi.

Neni 8

Përbërja, qarkullimi dhe importi i produkteve të caktuara

1. Produktet e caktuara mund të hyjnë dhe të qarkullojnë në tregun e Kosovës vetëm nëse i plotësojnë kushtet e parapara me këtë ligj dhe ligjet tjera në fuqi.

2. Produkti i caktuar i importuar dhe në qarkullim në tregun e Kosovës duhet të përmbushë kriteret ndërkombëtare për atë produkt, si dhe mos të përmbajë asnjë substancë të dëmshme në atë sasi që do të rrezikojë shëndetin e foshnjës dhe fëmijës së vogël.

Neni 9

Ndalimi i promovimit të produkteve të caktuara

1. Ndalohet promovimi i produkteve të caktuara në publik, në cilëndo formë, drejtpërdrejtë apo tërthorazi, nga ana e prodhuesit, distributorit, punëtorit të marketingut apo personave tjerë fizik dhe juridik që veprojnë në emër të tyre.

2. Ndalesa për promovimin e produkteve të caktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, përfshinë:

2.1. reklamimin me shkrim, në formatin audio dhe vizual, përfshirë edhe atë përmes internetit apo mediave sociale;

2.2. vendet për paraqitje, demonstrim dhe testim të produkteve;

2.3. shpërndarja dhe dhënia e një apo më shumë mostrave apo paketimeve të produktit të caktuar cilitdo personi;

2.4. metodat nxitëse për rritje të shitjes siç janë reklamat për shitje me çmim të ulur, shpërndarja/shitja e kuponëve për blerje me çmim të ulur, premiumet, rabatet, uljet e veçanta, shitjet nën çmimin e tregut, shitje të lidhura, dhurata ose shpërblime;

2.5. shpërndarja apo dhurimi i materialit edukativ apo informativi cili i referohet të ushqyerit të foshnjave apo fëmijëve të vegjël;

2.6. kryerja e aktiviteteve edukativo-arsimore në lidhje me të ushqyerit e foshnjave apo fëmijëve të vegjël; dhe

2.7. sigurimi dhe ofrimi për publikun ose për gra shtatzëna, nëna ose anëtarët e tyre të familjes, produkte me çmim më të ulët, mostra, dhuratë, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte përmes sistemit të kujdesit shëndetësor dhe çdo formë tjetër e promovimit.

3. Si përjashtim, prodhuesi, distributori, personeli i marketingut apo cilido person tjetër fizik dhe juridik që vepron në emrin e tyre mund të bëjë promovimin e ushqimit plotësues në rrethanat vijuese:

3.1. promovimi i tyre nuk zhvillohet në institucion shëndetësor dhe institucione për përkujdesje të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël; dhe

3.2. çfarëdo materiali në cilëndo formë, që promovon ushqimin plotësues, inkurajon të ushqyerit ekskluziv me qumësht gjiri për gjashtë (6) muajt e parë të jetës dhe deri në moshën dy (2) vjeç e më tepër.

4. Prodhuesit, distributori dhe çdo personi fizik e juridik i ndalohet:

4.1. t'u ofrojë çfarëdo sasi të produkteve të caktuara punëtorëve shëndetësor, institucioneve shëndetësore, shoqatave profesionale shëndetësore, institucioneve për përkujdesje të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël, me çmim më të ulët se çmimi i publikuar i shitjes me shumicë, apo në mungesë të këtij çmimi, me çmim më të ulët se tetëdhjetë përlind (80%) e çmimit të shitjes me pakicë;

4.2. të ofrojë apo japë falas punëtorëve shëndetësor, institucioneve shëndetësore dhe subjekteve të ligjit produktet e caktuara;

4.3. të jep donacion ose të shpërndajë punëtorëve shëndetësor, institucioneve shëndetësore, shoqatave profesionale shëndetësore dhe institucioneve për përkujdesje të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël, shërbime, pajisje ose materiale si p.sh. lapsa, kalendarë, posterë, fletore shënimesh, diagrame të rritjes, lodra, apo ndonjë formë tjetër, të cilat i referohen ose promovojnë emrin ose logon e kompanisë ose produktin e caktuar;

4.4. t'u ofrojë apo japë shpërblime, dhurata, përfitime financiare apo përfitime tjera punëtorëve shëndetësor, institucioneve shëndetësore, shoqatave profesionale shëndetësore dhe institucioneve për përkujdesje të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël, siç janë: vizita studimore, grante për hulumtime shkencore, fonde për takime, seminare, edukim të vazhdueshëm profesional, trajnime, konferenca dhe forma tjera të ngjashme;

4.5. sponsorimi i programeve të ndryshme në mediat e shkruara, audio-vizuale dhe elektronike, ngjarjeve, kampanjave, garave, linjave telefonike për këshillim, apo aktiviteteve tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me shëndetin e nënës dhe fëmijës;

4.6. të përfshijë vëllimin e shitjeve të produkteve të caktuara me rastin e kalkulimit të përfitimeve ose bonuseve të të punësuarve, si dhe të caktojë kuota për shitje të produkteve të caktuara.

4.7. të përfshijë vëllimin e shitjeve të produkteve të caktuara me rastin e kalkulimit të përfitimeve ose bonuseve për subjektet tregtare ekonomike, si dhe të caktojë kuota për shitje të produkteve të caktuara.

Neni 10

Ndalesat për punëtorët shëndetësor, institucionet shëndetësore dhe shoqatat shëndetësore

1. Punëtorët shëndetësor, institucionet shëndetësore dhe shoqatat profesionale shëndetësore ndalohen:

1.1. të pranojnë shpërblime, dhurata, kontribute apo përfitime, qofshin ato financiare apo të tjera, të çfarëdo vlere, nga një prodhues, distributor ose subjekt i ligjit për produktet e caktuara;

1.2. të pranojnë ose të shpërndajnë mostra të produkteve të caktuara;

1.3. të promovojnë dhe inkurajojnë përdorimin e produkteve të caktuara, përveç në raste të veçanta, kur ka indikacione mjekësore të dokumentuara për përdorimin e tyre.

2. Punëtori shëndetësor e ka të ndaluar marketingun e produkteve të caktuara.

3. Profesionisti shëndetësor në institucionin shëndetësor obligohet të përgatisë ushqimin që zëvendëson qumështin e gjirit, vetëm në rastet kur është e domosdoshme me indikacion mjekësor dhe kjo dokumentohet me raport mjekësor.

4. Profesionisti shëndetësor në institucionin shëndetësor obligohet ta njoftojë dhe edukojë prindin apo kujdestarin e foshnjës dhe fëmijës së vogël për mundësitë e të ushqyerit me produkte të caktuara, vetëm në rastet kur është e domosdoshme me indikacion mjekësor dhe kjo dokumentohet me raport mjekësor.

5. Produktet e caktuara mund të përdoren për qëllime të vlerësimit profesional ose të hulumtimeve në nivel të institucionit, vetëm me miratim paraprak me shkrim të Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 11

Aprovimi i donacionit

Përrjashtimisht, donacioni i pajisjeve, materialit edukativ dhe produkteve të caktuara nga prodhuesi, importuesi ose distributori mund të bëhet vetëm pas aprovimit me shkrim nga Ministria e Shëndetësisë. Këto pajisje dhe materiale nuk mund të mbajnë emrin ose logon e kompanisë, nuk mund t'i referohen formulës qumështore dhe mund të shpërndahen vetëm përmes institucioneve të sistemit të kujdesit shëndetësor.

Neni 12

Monitorimi

1. Monitorimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji në institucionet shëndetësore e kryejnë trupat administrativ si më poshtë:

1.1. Ministria e Shëndetësisë – Divizioni i shëndetit të nënës, fëmijës dhe shëndetit riprodhues;

1.2. Drejtori i institucionit shëndetësor;

1.3. Koordinator i cilësisë së institucionit shëndetësor.

1.4. Organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat tjera që merren me inkurajimin, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit të drejtë të foshnjave dhe fëmijëve, në bazë të marrëveshjes me Ministrinë e Shëndetësisë.

2.Koordinatori i cilësisë së institucionit shëndetësor informon me shkrim Drejtorin e institucionit shëndetësor për të gjeturat gjatë monitorimit, i cili obligohet që të merr masa për mënjanimin e parregullsive të gjetura dhe për këtë të informojë me shkrim Divizionin e shëndetit të nënës dhe fëmijës dhe shëndetit riprodhues në Ministrinë e Shëndetësisë.

3.Divizioni i shëndetit të nënës, fëmijës dhe shëndetit riprodhues, në rast nevoje e informon me shkrim inspektoratin përkatës për të gjeturat gjatë monitorimit.

Neni 13 **Organet e mbikëqyrjes dhe inspektimit**

1.Zbatimin e këtij ligji e mbikëqyrin inspektoratet dhe organet e tjera, në bazë të kompetencës së përcaktuar si në vijim:

1.1. Inspektorati Shëndetësor mbikëqyr zbatueshmërinë e nenit 4 paragrafi 3, 5, 6; nenit 9 paragrafi 1, paragrafi 2 nënparagrafët 2.3, 2.5, 2.6, 2.7; nenit 9 paragrafi 3, nënparagrafi 3.1; nenit 9, paragrafi 4 nënparagrafët 4.1, 4.2, 4.3, 4.4; nenit 10 dhe nenit 11.

1.2. Inspektorati i punës mbikëqyrë zbatueshmërinë e nenit 5; nenit 6; nenit 9 paragrafi 1; nenit 9 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.3, 4.4, dhe 4.6.

1.3. Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinës mbikëqyrë zbatimin e nenit 7.

1.4. Inspektorati i Arsimit mbikëqyrë zbatimin e nenit 9 paragrafi 1; nenit 9 paragrafi 2 nënparagrafi 2.5, 2.6; nenit 9 paragrafi 3 nënparagrafi 1; nenit 9 paragrafi 4 nënparagrafët 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4.

1.5. Inspektorati i tregut mbikëqyrë zbatueshmërinë e nenit 7 paragrafi 1; nenit 9 paragrafi 1; nenit 9 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2, 2.3, 2.4, nenit 9 paragrafi 4 nënparagrafët 4.2 dhe 4.7.

1.6. Komisioni për media mbikëqyrë zbatueshmërinë e nenit 9 paragrafi 1; nenit 9 paragrafi 2 nënparagrafët 2.1, 2.5; nenit 9 paragrafi 4 nënparagrafi 4.5.

Neni 14

Sanksionet Administrative

1. Për shkeljet e mëposhtme subjektet dënohen me gjobë për kundërvajtje si vijon:

1.1. për shkelje të nenit 4 të këtij ligji, personi fizik dënohet me gjobë prej pesëqind (500) euro;

1.2. për shkelje të nenit 5 dhe 6 të këtij ligji, ndërmarrjet e vogla dënohen me gjobë prej një mijë (1.000) euro ndërmarrjet e mesme dënohen me gjobë prej dy mijë e pesëqind (2.500) euro, ndërmarrjet e mëdha dënohen me gjobë prej pesë mijë (5.000) euro;

1.3. për shkelje të nenit 7 dhe 8 të këtij ligji, ndërmarrjet e vogla dënohen me gjobë prej një mijë (1.000) euro, ndërmarrjet e mesme dënohen me gjobë prej dy mijë e pesëqind (2.500) euro, ndërmarrjet e mëdha dënohen me gjobë prej pesë mijë (5.000) euro, prodhuesi, importuesi, distributori dënohen me gjobë prej njëzetë mijë (20.000) euro;

1.4. për shkelje të nenit 9 të këtij ligji, ndërmarrjet e vogla dënohen me gjobë prej një mijë (1.000) euro ndërmarrjet e mesme dënohen me gjobë prej dy mijë e pesëqind (2.500) euro ndërmarrjet e mëdha dënohen me gjobë prej pesë mijë (5.000) euro, prodhuesi, importuesi, distributori dënohen me gjobë prej njëzetë mijë (20.000) euro, personi fizik dënohet me gjobë prej një mijë (1.000) euro ndërsa personi juridik dhe entitetet tjera me gjobë prej pesë mijë (5.000) euro;

1.5. për shkelje të nenit 10 të këtij ligji punëtori shëndetësor dënohet me gjobë prej pesëqind (500) euro dhe në rast të përsëritjes, me revokimin e licencës për një (1) vit, ndërsa institucioni shëndetësor dënohet me pesë mijë (5.000) euro.

1.6. për shkelje të nenit 11 të këtij ligji prodhuesi, importuesi, distributori dënohen me njëzetë mijë (20.000) euro, ndërsa institucioni shëndetësor dënohet me pesë mijë (5.000) euro dhe merren masa që donacioni ti merret në mënyrë të përhershme.

Neni 15

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri Nr. 02/L-81 i shpallur me Rregulloren Nr. 2007/7 për inkurajimin dhe mbrojtjen e të ushqyerit të fëmijëve me qumësht gjiri të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe të gjitha dispozitat e akteve nënligjore të Ministrisë së Shëndetësisë që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -023
24 tetor 2015

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI